

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® Patch-5 Rapid

LLAÇ ME BAZË ÇIMENTOJE ME MPIKSJE DHE NGURTËSIM TË SHPEJTË, ME 1 PËRBËRËS QË APLIKOHET ME DERDHJE (SCC) PËR RIPARIME LOKALE MBI DYSHEME DHE PUNIME RIPARUESE TË BETONIT



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® Patch-5 Rapid është Ilaç me bazë çimentoje, me 1 përbërës, me mpiksje dhe ngurtësim të shpejtë dhe me konsistencë SCC (beton i vetëkompaktueshëm) që aplikohet me derdhje për riparime lokale mbi dysHEME dhe riparime të elementeve prej betoni, i cili plotëson kërkesat e EN 1504-3 (Kategoria R4) dhe EN 13813 (CT-C70-F7-AR2).

Konsistenca e Sika® Patch-5 Rapid mund të adaptohet duke reduktuar sasinë e ujit, për të bërë produktin më të përshtatshëm për aplikimet në vende me pjerrësi.

PËRDORIMET

Sika® Patch-5 Rapid është Ilaç çimentoje me rrjedhje të lirë dhe tkurrje të kompensuar për trashësi shtrese midis 15mm dhe 50mm, i përshtatshëm për:

- Restaurim betoni me derdhje Ilaçi brenda betoformave (trarë, kolona, kuverta urash).
- Riparime lokale dhe rikonstrukcion i dysHEMEVE industriale në mjedise të brendshme dhe të jashtme prej betoni ose me bazë çimentoje, fuga rrugësh, puseta dhe në përgjithësi aty ku kërkohet tharje e shpejtë dhe rezistencë e lartë ndaj abrazionit ose aty ku ndërprerja e shërbimit duhet të pakësohet.
- Punime restaurimi (Parimi 3, Metoda 3.2, EN 1504-9:2008). Riparim i betonit të copëtuar dhe të dëmtuar në ndërtesa, ura, vepra infrastrukture dhe superstrukture me derdhje betoni.
- Përforcim strukturor (Parimi 4, Metoda 4.4, EN 1504-9:2008). Rritje e kapacitetit bartës të strukturës prej betoni me shtim Ilaçi.
- Ruajtje apo restaurim pasiviteti (Parimi 7, Metodat 7.1 & 7.2, EN 1504-9:2008). Rritje e mbulimit me Ilaç apo beton shtesë ose me zëvendësim të betonit të ndotur apo të karbonuar.
- Aplikime dysHEMEJE (EN 13813, CT-C70-F7-AR2). Rikonstrukcion i dysHEMEVE industriale të

brendshme e të jashtme me bazë çimentoje me rezistencë ndaj abrazionit/ konsumimit.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përdorim i lehtë, pluhur gati për përzierje - thjesht shtoni ujë (dhe agregate nëse dëshironi)
- Mpiksje dhe ngurtësim i shpejtë
- Konsistencë SCC e adaptueshme (Sika® Viscocrete® technology), paraqet veti të shkëlqyera rrjedhjeje, punueshmëri dhe stabilitet
- Rezistencë e lartë ndaj abrazionit / konsumimit, kategoria AR2 me metodën BCA
- Pa segregim ose rrjedhje
- Për trashësi aplikimi midis 15 mm dhe 50 mm për shtresë (pa shtim agregatesh)
- Për trashësi aplikimi deri në 100 mm me shtim agregatesh të posaçme - rërë kuarci 6-12 mm
- Në përputhje me standardin EN 1504-3 si Ilaç riparues (kategoria R4)
- Në përputhje me standardin EN 13813 si Ilaç për aplikime mbi dysHEME (CT-C70-F7-AR2)

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance si Ilaç CC riparues për riparimin strukturor të betonit në ndërtesa dhe punime të inxhinierisë së ndërtimit, Kategoria R4 sipas EN 1504-3:2005, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i njoftuar i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe Iloji i testimit.
- Markë CE dhe Deklaratë Performance si Ilaç me bazë çimentoje për dysHEME, Kategoria CT-C70-F7-AR2 sipas EN 13813:2002, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i njoftuar i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe Iloji i testimit.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento Portland, agregate të përzgjedhura, tym silici (silica fume) dhe aditivë
Ambalazhi	thes 25 kg
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur, gri e errët
Jetëgjatësia	9 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të pahapur dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe në temperatura midis +5°C dhe +35°C. Të mbrohet nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor.
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: ~ 2.23 kg/lit
Përmasa maksimale e kokrrizës	~3.5 mm
Përmbajtja në jone të tretshme kloruri	≤ 0.05 % (EN 1015-17)

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes		Në + 5°C	Në + 10 °C	Në +20 °C	(EN 12190)
	1 h	-	-	~ 14 MPa	
	2 h	-	~ 19 MPa	~ 30 MPa	
	4 h	~ 26 MPa	~ 30 MPa	~ 45 MPa	
	24 h	~ 45 MPa	~ 47 MPa	~ 48 MPa	
	7 ditë	-	-	~ 60 MPa	
	28 ditë	-	-	~ 70 MPa	
Moduli i elasticitetit në ngjeshje	Rezultatet	Kërkesat Kategoria R4			(EN 13412)
	32.7 GPa	≥ 20 GPa			
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	1 ditë	7 ditë	28 ditë	(EN 196-1)	
	≥ 5.0 MPa	≥ 7.0 MPa	≥ 9.0 MPa		
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Rezultatet	Kërkesat Kategoria R4			(EN 1542)
	≥ 2.5 MPa	≥ 2.0 MPa			
Tkurrja / bymimi i kontrolluar	≥ 2.0 MPa				(EN 12617-4)
Kompatibiliteti termik	≥ 2.0 MPa				(EN 13687-1)
Reagimi ndaj zjarrit	Euroclass A1				
Absorbueshmëria kapilare	≤ 0.5 kg/m ² x √h				(EN 13057)
Rezistenca ndaj karbonimit	dk ≤ beton kontrolli (MC (0.45))				(EN 13295)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	12 - 14% ujë (3.0 L - 3.5 lt) për thes 25 Kg Për aplikime në pjerrësi, mund të reduktohet sasia e ujit deri në 10% (2.5 lt për thes 25 Kg).
Konsumimi	~ 2.0 kg pluhur për 1 lt miks ose për 1 mm trashësi për m ² , në varësi të ashpërsisë së nënshtresës dhe dendësisë e llaçit të freskët.
Trashësia e shtresës	min. 15 mm - max. 50 mm min. 15mm - max. 100 mm me shtim 25% për peshë rërë kuarci 6-12 mm
Konsistenca	25 kg pluhur prodhon afërsisht 12.5 litra llaç
Aftësia për rrjedhje	240-280 mm Metodë e brendshme Sika 65-85 cm EN 12350-2 me konin Abrahms

~ 40 cm EN 13395-2 Grout Flow through, with flow channel

Temperatura e produktit	+ 5°C min. / + 30°C max.
Temperatura e mjedisit	+ 5°C min. / + 30°C max.
Temperatura e nënshtresës	+ 5°C min. / + 30°C max.
Koha e punueshmërisë	~20 min në 20°C

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Beton:

Nënshtresa duhet të ketë strukturë të qëndrueshme, të jetë plotësisht e pastër dhe pa ndryshk, papastërti dhe materiale të lira, ndotje sipërfaqësore si vaji, graso, kore betoni të cilat reduktojnë lidhjen ose parandalojnë përthithjen apo lagjen. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes duhet të jetë > 1.5MPa. Betoni i shpëtëzuar, i dobët, i dëmtuar dhe i shkatërruar dhe aty ku është e nevojshme edhe betoni i shëndetshëm - por jo deri në dëmtim të integritetit strukturor - duhet të hiqet me teknikat e përshtatshme e përgatitjes mekanike, si pastrimi me rrymë uji në presion të lartë ose me fryrje me rrymë rërë. Nuk preferohen metoda pastrimi me vibrim. Ashpërsori sipërfaqen e betonit që të ekspozohen agregatet deri në 2 mm në përputhje me EN 1766 ose CSP 5 nga Udhëzimet ICRI. Skajet e zonës së ndikuar nga ndërhyrjet duhet të priten në mënyrë përpjendikulare (90 gradë) deri në thellësi min. 5 mm. Rezistenca e betonit ndaj tërheqjes (pull-off) duhet të jetë > 1.5 MPa. ndiqni udhëzimet edhe nga supervizori ose një inxhinier i kualifikuar.

Çelik:

Sipërfaqja e çelikut duhet të pastrohet nga ndryshku, llaçi, mbetjet e betonit, vaji, grasoja, pluhuri dhe materiale të tjera të lira të cilat mund të reduktojnë ngjitjen ose të krijojnë korrodimin. Në rast ndryshku, pastroni të gjithë perimetrin e shufrave të çelikut (ku është e aplikueshme) me teknika pastrimi me rrymë abrazive ose ujë me presion të lartë deri në Sa 2 në përputhje me ISO 8501. Mbroni shufrat e pastruara nga kontaminimi i mëtejshëm, përpara aplikimit të llaçit.

Betoformë:

Çdo betoformë duhet të ketë kapacitet mbartjeje të ngarkesës dhe forcave të ushtruara mbi të. Betoforma duhet të jetë e pastër dhe e vendosur në pozicion pas përgatitjes së nënshtresës dhe armaturës. Disarmantët si seria Sika® Separol®, duhet të aplikohen përpara vendosjes në pozicion së shufrave për të shmangur kontaktin me nënshtresën e përgatitur. Betoforma duhet të jetë projektuar saktë, për të lejuar kalimin e ujit dhe ajrit, për të suportuar teknikën e derdhjes, për të ofruar mbushje të plotë, për të siguruar rrjedhje të lirë, për të parandaluar rrjedhjen e produktit, etj. Ju lutemi këshillohuni me Sika Albania SHPK për suport teknik dhe udhëzime specifike.

Për kërkesa specifike, referohuni gjithashtu tek EN 1504-10.

PËRZIERJA

Sika® Patch-5 Rapid mund të përziehet me një mikser elektrik manual në shpejtësi të ulët (~500 r.p.m.) me aks vertikal për 1 deri në 2 thasë, duke u kujdesur për të mos bllokuar ajër brenda miksit ose me një mikser me kovë për 2 ose 3 thasë ose më shumë - njëherësh, në varësi të llojit dhe përmasës së mikserit. Hidhni ujë në raportin e saktë të dëshiruar brenda një ene të përshtatshme. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni gradualisht pluhurin tek uji dhe përzieni për të paktën 3 minuta, duke shtuar (nëse nevojitet) ujë shtesë gjatë kohës së përzierjes deri në sasinë max. të specifikuar dhe derisa të arrihet një konsistencë homogjene dhe pa kokrriza. Për mikse më të mëdha, koha e përzierjes mund të zgjatet (deri 5 minuta ose sa të nevojitet) derisa llaçi të jetë përzierë në mënyrë të njëtrajtshme pa kokrriza dhe pa mbetje pluhuri të thatë. Përzieni thasë të plotë për rezultate më të mira. 25 kg pluhur Sika® Patch-5 Rapid përzieret me 3.0 - 3.5 L ujë në varësi të konsistencës së kërkuar.

APLIKIMI

Sika® Patch-5 Rapid mund të aplikohet manualisht me teknika tradicionale duke e derdhur brenda kavitetëve ose betoformave. Nëse nevojitet, mund të pompohet me pajisje standarde (p.sh. Turbosol, Putzmeister).

Lagje paraprake:

Sipërfaqet e betonit duhet të saturohen me ujë të pastër min. 2 orë përpara aplikimit, duke siguruar se të gjitha poret dhe gropëzat janë mjaftueshëm të lagura. Sipërfaqja nuk duhet të thahet përpara aplikimit të llaçit. Pak përpara aplikimit, hiqni ujin e tepruar dhe sigurohuni se mbi sipërfaqe nuk ka ujë. Sipërfaqja duhet të arrijë një paraqitje mat të errët pa shkëlqim dhe poret dhe gropëzat nuk duhet të përmbajnë ujë (tharje e sipërfaqes së saturuar - SSD). Përdorni ajër me presion (pa vaj) për të fryrë tej ujin e tepërt në zona të vështira.

Derdhja / mbushja:

Produkti duhet të derdhet direkt mbi nënshtresën e lagësht mat ose brenda betoformës së përgatitur për derdhjen. Duke përdorur më shumë se një mikser dhe me organizimin e duhur, mund të dredhni materialin e freskët duke pakësuar fugat e ndërimit. Pas përzierjes, Sika® Patch-5 Rapid lëreni llaçin të qëndrojnë për ~1-2 minuta; përzieni sërish me një mallë dhe pastaj derdhni menjëherë mbi betoformat e izoluar, të qëndrueshme dhe të përgatitura. Për të përfituar nga vetitë zgjeruese të produktit, aplikoni llaçin sa më shpejtë të jetë e mundur (max. brenda 15 minutash). Koha e punueshmërisë duhet të merret gjithashtu parasysh, duke e adaptuar sipas kushteve klimaterike, kur planifikoni kohëzgjatjen e punës.

Prajmer / mbrojtje kundër korrodimit të armaturës:

Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Patch-5 Rapid
Korrik 2020, Botimi 01.01
020302040030000185

BUILDING TRUST



Mbi një nënshtrësë të mirëpërgatitur dhe të ashpërusar, në përgjithësi prajmeri nuk kërkohet. Kur kërkohet prajmer dhe/ ose veshje kundër korrodimit të armaturës (p.sh. Sikadur®-32 EF, Sika MonoTop®-910 ose SikaTop® Armatec®-110 Epocem®) referohuni tek skeda teknike përkatëse për më shumë informacione të detajuara. Në çdo rast, prajmeri / mbrojtja kundër korrodimit të armaturës duhet të aplikohet mbi një nënshtrësë paraprakisht të lagur dhe aplikimi vijues i Sika® Patch-5 Rapid duhet bërë i lagësht mbi të lagësht. Koha e punës së prajmerit dhe/ose mbrojtjes kundër korrodimit të armaturës, duhet të merret parasysh nëse plotëson kërkesat e aplikimit.

Trashësia max. e shtuar e shtresës:

Për aplikime në sasi të madhe (> 20 lt) ose në trashësi të madhe (> 50mm), trashësia max. e shtuar e shtresës mund të arrihet me shtresëzim ose me shtim agregatesh.

Shtresëzimi:

Shtresa e parë duhet të ngurtësohet dhe reaksioni ekzotermik i materialit duhet të përfundojë. Shtresa e 1-rë duhet të fillojë të mpikset dhe të jetë në temperaturë ambiente përpara aplikimit të shtresës së dytë. Mos niveloni shtresën e parë përpara aplikimit të shtresës së dytë. Shtresa e 1-rë duhet të pastrohet me ujë në presion të ulët ose ajër të kompresuar përpara aplikimit të shtresave vijuese të llaçit.

Spërkatje me agregate shtesë:

Hidhni ujë në raportin e saktë brenda një ene të përshtatshme për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni Sika® Patch-5 Rapid tek uji. Përzieri me një mikser manual në shpejtësi të ulët (< 500 r.p.m.) për të shmangur bllokimin e ajrit. Përzieri plotësisht për të paktën 3 minuta derisa miksi të bëhet homogjen dhe pa kokrriza. Në vijim, shtoni gradualisht rërë kuarci 6-12 mm (25% për peshë Sika® Patch-5 Rapid) dhe përzieri ngadalë për 1-2 minuta më shumë derisa të bëhet homogjen.

Përzieri thasë të plotë për rezultate më të mira. Mos tejkaloji raportin max. të ujit për përzierje. Rëra e kuarci 6-12 mm është e ambalazhuar në thes 25 kg, me kokrriza të rrumbullakëta, pa përmbajtje filleri (mbushës), agregate të pastra dhe me granulometri të mirë. Çdo agregat tjetër duhet të vlerësohet përpara çdo përdorimi.

- **Sistemi:** Sika® Patch-5 Rapid + 6,25kg rërë kuarci 6-12mm
- **Ujë:** 3.0-3.5 (kg)
- **Trashësi shtrese:** 15-100 (mm)

Kontaktini me suportin teknik të Sika Albania SHPK për më shumë detaje specifike dhe raporte testimi të brendshëm në lidhje me karakteristikat e Sika® Patch-5 Rapid me shtim rërë kuarci 6-12 mm.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Konsideroni të magazinoni thasët në mjedis të ngrohtë dhe përdorni ujë të ngrohtë për të ndihmuar në arritjen e rezistencave dhe ruajtjen e vetive fizike, kur mbizotërojnë kushte të ftohta moti.
- Mbroni produktin e freskët të aplikuar nga dielli dhe era për të paktën 24 orë pas aplikimit
- Kontrolloni gjithmonë materialin pas pompimit
- Sigurohuni se betoforma është mjaft e fortë për të mbajtur llaçin e freskët dhe të izoluar për të parandaluar rrjedhjen
- Trajtoni sipërfaqet e ekspozuara menjëherë me fleta ose membrana mbrojtëse. Mbroni llaçin e freskët nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, era dhe ngrica.
- Finironi sipërfaqen e ekspozuar sipas dëshirës sapo llaçi të fillojë të ngurtësohet. Mos hidhni ujë shtesë mbi sipërfaqe.
- Shmangni rënien e lirë të materialit për të parandaluar segregimin e agregateve
- Përzierja duhet kryer gjithmonë me mjete mekanike; përzierja manuale nuk lejon arritjen e punueshmërisë optimale
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar
- Mos shtoni çimento apo substanca të tjera që mund të ndikojnë mbi vetitë e llaçit
- Mos shtoni ujë apo llaç të freskët tek një miksi llaçi e cila ka filluar të mpikset
- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ ose erë të fortë
- Aplikoni vetëm mbi nënshtrësë të qëndrueshme dhe të përgatitur. Në rast shtrimi dyshemesh, sidomos në mjedise të jashtme, shmangni tharjen e shpejtë të produktit gjatë ditëve të para të maturimit.
- Mos shtroni dysheme në kushte të keqja moti, të cilat do të ndikojnë negativisht mpiksjes dhe procesin e ngurtësimit të produktit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sika® Patch-5 Rapid
Korrik 2020, Botimi 01.01
020302040030000185

SikaPatch-5Rapid-sq-AL-(07-2020)-1-1.pdf

